

Ali M. Ahmeti

GJËMËTARËT SHQIPTARË NGA GUCIA DHE PLAVA

Vajtimet dhe gjëmat, sikurse dhe krijimit e tjera lirike popullore, kanë pasur zhvillimin e vet historik duke qenë të kushtëzuara nga ndryshimet shoqërore, të cilave u janë përshtatur, por duke i ruajtur gjallë disa karakteristika tradicionale të kohëve më të lashta. Mirëpo, vajtimet e gjëmat kanë pranuar edhe elemente të reja, varësisht prej rrethanave në të cilat janë krijuar.

Karakteristikë kryesore e vajtimeve është se kanë karakter ritual. Bile, sipas mendimit të Vukoman Xhakoviçit, vajtimet si këngë u lindën nga këngët rituale që disponojnë veçori të veta që i dallojnë përkrah mënyra e të krijuarit, përmbajtjes dhe formës.¹

Edhe vajtimet e gjëmat shqiptare, krahas me ato të popujve të tjerë të Ballkanit, krijohen duke bërë ndikim reciprok, mirëpo edhe i ruajnë specifikat me të cilat dallohen prej atyre të popujve të tjerë fqinjë dhe më të largët.

Zhvillim të mirë kanë edhe sot nëpër ato vende ku ruhen gjallë traditat e hershme. Kjo ngjet edhe në trevën e Plavës dhe të Gucisë, ku vajtimet e gjëmat krijohen nga burrat dhe gratë, veprim ky që është obligim moral për secilën familje që pëson tragjedi, me vdekjen e ndonjë anëtarit të familjes të gjëmojë burri ose të vajtoje gruaja. Po ashtu edhe brimtari a vajtorja duhet t'u përgjigjen këtyre kërkesave shoqërore gjithnjë duke qenë të shtyrë nga humaniteti i lartë i tyre, që ta bëjnë këtë punë me nder. Këtë e pohon edhe Tihomir Gjorgjeviç, i cili thotë: „Vajtimi është njëfarë obligimi që vajtorja a brimtari ia ka borxh të vdekurit”.²

Në Krahinën e Plavës dhe të Gucisë vajtojnë gratë dhe gjëmojnë a lëshojnë britma burrat, si të besimit islam ashtu edhe katolik. Mirëpo, ato të burrave janë më të rralla dhe dita më ditë janë duke u zhdukur. Disa brimtarë myslimanë të këtyre anëve nuk janë prezentuar ndonjëherë përpara opinionit, por atë punë e kanë bërë në vetmi, ndërsa të tjerët dhe ata të besimit katolik ndjekin rrugën tradicionale.

¹ Vukoman Džaković, *Crnogorske narodne tužbalice*, „Grafički Zavod”, Titograd, 1970, f. 12.

² Tihomir Đorđević, *Nekoliko smrtnih običaja*, God. Nik. Čučića, XVII Beograd, 1913, f. 184.

Gjëmat janë shumë të vjetra gjë që dëshmojnë edhe të dhënat, për çfarë është folur edhe në studime të tjera, të publikuara. Te shqiptarët e Krahinës së Plavës dhe të Gucisë, vërejmë veçori të ngjashme a identike të gjëmave të burrave me ato të krahinave të etjera shqiptare. Në trevën e përmendur thuhet se burri *po bân gjâmë, po gjïmon, po thrrët vaj, po bân brimë, po bërtet* ndërsa të pranishmit e ndjekin sikur t'ishin duke e dëgjuar këngëtarin kur interpreton këngë epike a lirike të shoqëruara me çifteli ose lahutë. Por burri nuk gjëmon kurrë për gruan, sepse konsiderohet „marre” (turp). Me përpara burrat kanë nxjerrë vetëm klithma nga dufi i tyre shpirtëror, ku mungonte teksti apo kur ai zë vend të vogël në tërësinë e të gjëmuarit. Klithmat kishin këtë përmbajtje, si: ku — ku për mua! I mjeri u i mjeri! Uh, uh, uh, uh, uh...! Ëh, ëh, ëh, ëh, ëh... dhe pasthurma të tjera duke i përsëritur, nga, besoj se ka dalë edhe termi *britmë a gjëmë*. Të njëjtat i ka karakterizuar edhe shkurtësia. Sot gjëmën e takojmë të jetë e shoqëruar me më shumë tekst. Gjëma përfillet prej burrave edhe sot e gjithëditën në trevat e përmendura, të cilët e kanë ruajtur atë formë tradicionale të të lëshuarit britmë-gjëmë. Ndërsa në vajtimet e votme vendin kryesor në të përmendurat zë teksti, pra klithmat kanë shtrirje më të vogël. Këtë ndryshim e kanë vërejtur edhe banorët e këtyre anëve të cilët përveç të tjerash thonë: „Përpara kanë gjimue njerzit — burrat nryshe, sepse ata veç kanë bërtitë e tash i thrrasin të dekunin edhe fjalë tjera”.

Këto gjëmë i përshkojnë disa veçori dalluese nga ato të grave, meqë gjëmëtari shqiptar i Krahinës së Plavës dhe të Gucisë, sikurse edhe ata të krahinave të tjera shqiptare, zakonisht vajton për njerëz të moshës së pjekur dhe të njohur — të shquar, por çfarë është e rastit te shqiptarët, ata vajtojnë edhe për të afërmit e vet sidomos ata të besimit islam të shtyrë nga ndonjë rast i rëndë tragjik familjar, siç është rasti i Sokol A. Brunçajt nga fshati Vuthaj, i cili gjëmon në vetmi për të birin që iu mbyt nga vërshimi, dhe pas atij rasti gjëmon edhe për shokët dhe të tjerët. Nxitjen për t'u marrë me një gjë tëkëtille e shkakton kryesisht tragjedia, si në rastin e përmendur, qoftë edhe në radhët e femrave vajtoresh. Disa, pra, e kanë bërë shprehi me çka edhe njihen sot në këtë trevë.

Gjëmëtarët deri para disa vjetësh ishin vetëm nga radhët e atyre të besimit katolik, të cilët e ruajtën si trashëgim.

Edhe në këto anë mbretërojnë disa zakone — rite rreth mënyrës të të gjëmuarit, që i kanë ruajtur dhe i kanë rrënjët në lashtësi, disa nga ato janë: shkulja e flokëve, gërvishja e fytyrës me thonj të ruajtur për raste të këtilla, dhe ashtu të përgjakur qëndrojnë para masës, njëherësh rrahin gjoksin me duart e bëra grushta, përveç tekstit që thonë për të ndjerin, në ç'mënyrë dëshmojnë edhe më shumë për pikëllimin që u është mbjellë me rastin e vdekjes së shokut, mikut a dashamirit të tyre. Ata jo vetëm që u përkushtohen njerëzve të shquar, por edhe vetë janë njerëz të pajisur me cisësi të larta morale — burrërore.

Gjëmëtarët, duke qëndruar në ballë të kolonës që i shkojnë në ngushëllime familjes të të vdekurit, pasi t'i jenë afruar vigut, shkëputën nga kolona, e përshëndesin të vdekurin (më përpara hudheshin mbi të dhe e përqafojnë), largohen nga ai dhe zënë të gjëmojnë-bërtasin, herë duke i vendosur duart e bëra grushta në gjoks, e herë duke i vendosur në brez. Ashtu të shtanguar, me një pamje trishtuese fillojnë të bërtasin për të vdekurin. Gjatë qitjes së hapave — duke ecur, nuk gjëmojnë. Ata zakonisht fillojnë të ecin me këmbën e majtë. Pasi gjatë ecjes ndalen i thonë nga disa vargje herë të shoqëruara me klithma e herë të përbëra vetëm nga teksti. Zakonisht klithmat janë të kësaj forme: *Ëh, ëh, ëh, ëh, ...! I mjeri û i mjeri!* Ndërsa masa qëndron e renditur në formë të gjysmërrëthit.

• Gjëmëtari profesionist i këtyre anëve, pasi të ketë lëshuar gjëmë, klithma, zakonisht bën me dije për kobin që ka ngjarë, ai e ka prekur në shpirt edhe atë, që është njëkohësisht edhe i të afërmeve të të vdekurit edhe i masës, që merr pjesë këtu në ngushëllime, me qëllim që të takohen për herë të fundit me të vdekurin. Këto vargje i përshkon një notë realiste:

*I mjeri û, o Bubë Binaku!
I mjeri u për ty-e
E për kyt haber t'zi,
Çi e muerrme sot për ty,
E për kyt ditë t'shkretë,
Çi ktu na ka përppjekë.³*

Shpeshherë gjëmëtari njofton, në vargjet e para, për shkakun e vdekjes se të ndjerit cili ishte shkaktar që ta ndajë — ta shkëpusë përgjithmonë nga të afërmit, të cilët e kishin çmuar dhe respektuar shumë për virtytet që kishte pasur

*Kjoft mallkue aj plum alltije,
që t'dau Can shoqniyet!*

*E t'dau prej kumarijet,
e t'dau nipit e bijet,
e t'dau miqsijet.⁴*

Në pjesën më të madhe të gjëmave vihen në pah virtytet e larta që i kishte i ndjeri. Këto merita, sipas gjëmëtarit, në të shumtën e rasteve i kishte trashëguar nga të parët e tij, të cilat ai dëshiron të trashëgohet edhe në breznitë e ardhshme. Pra, kjo dëshmon se krijuesi popullor i këtij zhanri mendon se mund të bëhet i mirë

³ Idriz Ulaj, *Këngë populore nga Gucia, Prishtinë, 1980, f. 79.*

⁴ Shënoi Ali M. Ahmeti, *Dol — Guci, gusht 1977.*

vetëm ai që e ka pjellë trashëgimie. Ky mendim i ka meritat e veta, megjithëse mban njëanshmërinë. Ai lëshon britma shpesh me gojën dhe shpirtin e farefisit të të vdekurit, në ç'rast shpreh edhe frikën se pasardhësit e të vdekurit nuk do të mund të shquhen si ai. Këto merita ia numëron në vargjet ku është prezente me një masë edhe hiperbola:

*Je kën burr deret,
e je kën burr neret,
e je kën burr oxhakut,*

*Faqja e bardh e krejt bajrakut. (...)
Se je kën pika e sokolit!
e kur ke dal në lug t'bajrakut,
i ke çue faqën e bardh,
konakut e gjith bajrakut.
Je kën lulja e dasmorit,
besa e burrit, zâna e mizorit.
e i ke pas kraht e dragonit.⁵*

Vdekja e burrit që kishte virtyte të larta si: nderin, besën, burrërinë, trimërinë, mikpritjen, mençurinë, dashurinë për punë e të tjera, gjëmëtarin e bën që t'i lëndohet zemra, sepse do të largohet edhe një yll që i shndriti në rrugë të ndryshme të jetës. Përveç virtyteve të të ndjerit, përshkruhet edhe portreti fizik i tij në kohën kur ai ka vdekur, çfarë prek dhe lëndon edhe më shumë zemrat e të pranishmëve, që paraqet një kontrast të madh me atë që ishte më parë:

*Tash un g-jat t'u kâm afrue,
po ti, heu kënke shkretue —
shtati t'u paska rrxue,
duert posht m'i paske lshue,
syt t'u paskan verbue,
goja t'u paska shkrumue,
dhâmt t'u paskan rrafshue
si me pa dasht dekën me kafshue.⁶*

Me klithma karakteristike gjëmëtari e thërret të vdekurin që t'i presë e t'i përcjellë burrat që kanë ardhur ta vizitojnë e të mos heshtë. Pra, ai nuk pajtohet me gjendjen në të cilën ka rënë i ndjeri, por dëshiron që të jetë vital si edhe më parë. Ja se si i drejtohet:

⁵ Instituti Albanologjik, *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë, 1973, Nr. III, f. 203, shënoi A. Çetta.

⁶ *Poaty*, f. 204.

Çou, neshe vllaznin,
 çou, neshe miqsin,
 çou, neshe probatinin,
 çou, neshe kumarin,
 çou, daje pleqnin,
 se besa e zotit ja ke dit rênin!⁷

I vdekuri dikur ishte i njohur jo vetëm në rrethin ku jetoi, por edhe më gjerë. Gjëmëtari dëshmon të jetë i tillë edhe në atë jetë, ku do të luftojë edhe më tutje për çështjen kombëtare, sikurse luftoi së bashku me bashkatdhetarët e tjerë të njohur. Ai e lut që të mbajë marrëdhënie të mira me të vdekurit e tjerë dhe atje të vazhdojë misionin e filluar në këtë jetë. Ky element, që të këtilla ka mjaft në vajtimet e gjëmat e këtyre krahinave, dëshmon besimin se i vdekuri nuk vdes, po ndërron jetë që më tepër është dëshirë sesa të zhdukej përgjithmonë, çfarë i shëron sadopak plagët e të gjallëve. Ky është element i përgjithshëm i vajtimeve botërore:

ne m'u nesh n'ata burra t'vjetër,
 që e kan marr kanun me vete:
 n'Marash Palin e n'Deli Pjetrin.
 N'u mërzitsh për ata shaljân,
 n'Kala t'Shkondrës ti i gjân.
 Jau nep dorën se â kreja e vënit,
 n'Malsi t'Shalës e Mehmet Shpendit.
 N'muhabet e n't'mirë t'mikut,
 ja nep dorën Mark Sadikut,

.....
 Ded Gjon Lulit, Marash Delis.
 e njer t'Stambollit e Zeqirit,
 ja nep dorën Lek Dugagjinit.
 Dhe për punt e letërsisë
 Gurakuqit e Pashkëndis.
 Ali Binak e Mulozmâne. (...)

M'i bân t'fala Pjetër Balës.
 M'i thuej n'kjoft kên dragoni i Shalës:
 çonju fjal thuej Nok Gjeloshit,
 e bânju burrat e Shalës e t'Shoshit,
 edhe lidhnju dorë për dorë,
 me ata vllazën mirditorë" —
 qitjani zânin krejt Malsisë,

⁷ Po aty, f. 204.

⁸ Shënoi Ali M. Ahmeti, Dol — Guci, gusht 1977.

Në gjëmat e burrave jo rrallë shprehen ndjesitë e thella shpirtërore. Ky është rezultat i afinitetit dhe i gjendjes së tij shpirtërore që i lind për njeriun e dashur që e ka humbur, duke e lënë përgjithmonë të mjerë. E këtillë është gjëma që e bën babai për djalin e vet. Këtu ai pasqyron gjendjen në të cilën kishte rënë i biri i tij i paluar në tokë, trupi i të cilit tashmë ka filluar të dëmtohet nga dheu. Larg shkollës dhe shokëve me të cilët dikur i jepte bukuri natyrës duke luajtur dhe me qëndrimet e tjera të tij:

*E shum ka dit-o librin s'e ke lexua,
o se nuk munesh se sytë t'u kan'qorrua!
E po shum'ka dit o n'fletore nuk ke shkrua!
o s'mune lapsin, o pllumo me shtërgua,
e se ty gishtat, medet, o t'u kan'shkurtua!⁹*

Gjëmëtarët ndonjëherë pasqyrojnë natyrën, bagëtinë dhe jetën e dikurshme që ishte e mbushur plot gjallëri; kur dëgjohej kënga e bariut, lozja e tij shok me shok, kur s'e mundonte asgjë, blegërima e deles, jehona e këmborës së oqiçit, duke u prirë deleve nëpër male të larta e të thepisura. E tani bariu i dikurshëm, i njohur edhe si këngëtar i shquar, tani kur është i rënduar nga pesha e moshës dhe e problemeve që ia solli koha, gjëmon me një fuqi dhe mall të pakapërcyeshëm;

*E tash po dua, medet, he, me vajtua,
e besa njeto bjeshkë — o besa ç'i janë shkretua,
e kurrku s'niej — o paj, delme tue blegrua,
e kurrku s'niej — e kumonë — o tye ushtua,
e kurrku s'niej — e po, fyell — o tye çllua,
e kurrku s'niej, medet, çoban tye knua,
e paj njashtu, o medet, s'janë kënë pa'msua!¹⁰*

Gjëmëtarë jep një portret të qëlluar të bariut të këtyre viseve, i cili nuk shquhej vetëm për punën që e bënte si bari, por edhe me tipare të tjera të njeriut me virtyte. Sidomos shquhej për shkathtësinë e madhe që kishte si bari, kur edhe bagëtia ishte ajo që dallohej nga tubët e barinjve të tjerë. Për të bërë një pasqyrim më të qëlluar poetik, gjëmëtarë i shfrytëzon me maturi figurat e tropet:

*E paj â kënë, medet, o Fazli Haziri.
e i ka pasë hije, medet, me besatue,
e calla âsht kënë o, medet, sokol qafash,
e i ka pasë o, besa, ato dhën krenare,
ka pasë oqiç, medet, ka pasë kumon-e,
e n'për ato maje-e, medet, gjothmonë tye vikat-e¹¹*

⁹ Shënoi Ali M. Ahmeti, Vuthaj — Guci, nëntor 1978.

¹⁰ Shënoi Ali M. Ahmeti, Vuthaj — Guci, 1978.

¹¹ *Ibidem.*

Gjëmat e improvizimet e meshkujve, në krahasim me vajtimet e grave, janë më të varfëra përkaq brendia. Ato i përshkon një varg epitetesh të njëjta e të ngjashme. Në to paraqiten një varg tablosh nga jeta e personit të vdekur. Ato shquhen me pikëllimin që është më tepër i shfaqur me klithma sesa nga emocionet e gjëmëtarit. Kjo dëshmon, përveç të tjerash, se meshkujve nuk u shkon përdore të vajtojnë aq sa grave. Për këtë me të drejtë Njegoshi thekson: „Meshkujt durojnë, ndërsa gratë vajtojnë.”

Brimtarët profesionalë të kësaj ane jo vetëm që kanë bërë gjëmë për të vdekurit shqiptarë, pa marrë parasysh të cilit besimi i takojnë, por kanë gjëmuar edhe te malazezët dhe serbët. Kjo është një dëshmi se marrëdhëniet ndërmjet tyre, në këto raste, kanë qenë dhe janë të mira.

Vlen të shtohet se në këtë anë, si u tha edhe më lart, gjëmëtarët që bënin britma para masës, ishin nga radhët e besimit katolik nga fshati Dol. Këta njiheshin edhe me virtyte të larta burrërore, trimërore e të tjera. Nga radhët e shqiptarëve të besimit islam njihen disa gjëmëtarë që kanë zënë të shquhen në këtë fushë kohëve të fundit. Mirëpo, këta bëjnë gjamë vetëm kur ndodhen në vetmi, jashtë prezencës së masës dhe të vdekurit, në rastet kur përmallohen për të vdekurin, që ishte shkaktar të fillojnë këtë punë, duke punuar apo udhëtuar apo në raste të tjera. Gjëmët e tyre, i përshkon nota e thellë pikëlluese, çfarë është e arsyeshme plotësisht, sepse zemra e tyre është e lënduar shumë më rastin e vdekjes të të afërmeve të tyre. Nga njëri patëm rast edhe të shënojmë disa vargje për të birin e tij dhe disa gjëma të tjera të tij që i thoshte fshehurazi. Ky ishte rast mjaft i vështirë. Pasi dëgjuam se gjëmon, shkuam te ai dhe iu lutëm që të na i thotë vargjet e gjëmës për të birin e tij. Edhe pse iu lëndua shpirti për të birin, kur e vajtoi i ra të fiktë. Ky është rast i rrallë që nga burrat shqiptarë të besimit islam të vajtojë ndokush.

Gjëmat e burrave nuk japin njohuri të shumta për botën në të cilën i vdekuri veprimi dhe u shqua për së gjalli. Pra, atij i përmenden një varg cilësish, pa u thelluar në esencën jetësore dhe në veprimet e tij gjatë jetës. Këtë e dëshmon edhe shkurtësia e tyre.

Nga materiali i mbledhur në terrenin e përmendur dhe ai i konsultuar, që u botua nga bledhës të ndryshëm të folklorit, vërehet se gjëmat e burrave arrijnë gjatësinë deri në 100 vargje. Si u tha në fillim të këtij kapitulli, gjëmat e burrave dita-ditës janë duke mpleksuar më vete më shumë tekst dhe po pajisen me elementin e ndjesisë së thellë shpirtërore, me çfarë po u afrohen vajtimeve të grave, megjithëse ruajnë gjallë shumë nga karakteristikat e veta më të cilat dallohen nga ato të grave. Le të na kujtohen ato të burrave myslimanë, që gjëmuar dhe gjëmojnë jashtë prezencës të të vdekurit. Te këta të fundit vërehet se nuk lëvizin as që bëjnë farë veprimesh rituale, çfarë dëshmon se po largohen nga ato qëndrime që u përkasin kohëve të kaluara, megjithëse te profesionistët janë ruajtur.

Vajtmet e kësaj treve janë të ngjashme me ato të krahinave të tjera të Shqipërisë së Veriut dhe me të disa të krahinave të Kosovës. Kjo dëshmon për bazën e përbashkët dhe se marrëdhëniet midis këtyre kanë qenë të pashkëputura, mirëpo, megjithatë ato kultivojnë dita me ditë në vete elemente autentike.

LITERATURA

1. Lambertz, Maximilian, *Die Volkspoesie der Albaner*, Sarajevo, 1917.
2. Mitrushî, Llambrini, *Zakonet dhe ritet e ceremonialit të vdekjes në Myzeqe*, Etnografia shqiptare V, Tiranë 1974.
3. Đurić, Vojislav, *Postanak i razvoj narodne književnosti*, Beograd, 1954.
4. Đurić, Vojislav, *Tužbalica u svetskoj književnosti*, Beograd, 1940.
5. Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Enti i Botimit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1972.
6. Džaković, Vukoman, *Crnogorske narodne tužbalice*, „Grafčki Zavod”, Titograd, 1970.
7. Đorđević, Tihomir, *Nekoliko smrtnih obiçaja*, God. Nik, Čupića XVII Beograd, 1913.
8. Banjićević, Branko, *Polje Jadikovo* (Antologija crnogorskih narodnih tužbalica) „Grafčki Zavod”, Titograd, 1971.

Ali M. Ahmeti

LES LAMENTATIONS DES HOMMES CHEZ LES ALBANAIS DE GUCI ET PLAVA

Résumé

Diverses données témoignent de l'origine ancienne des lamentations funèbres. Les lamentations des albanais de Guci et Plava présentent des particularités semblables à celles des autres provinces albanaises et autres peuples.

Les habitants des régions mentionnées lorsque l'homme improvise disent: „po bân gjâmë, po gjimon, po thrret vaj, po bân brîmë, po bërtet” / il se lamente, il appelle la lamentation, il crie, il cris.

A la différence des lamentations d'autrefois, qui comportaient principalement des cris exprimés par diverses exclamations, celles d'aujourd'hui comportent un texte parcouru d'un profond sentiment lyrique, sur ce point elles ressemblent aux lamentations des femmes. Les habitants de cette région témoignent de ce fait lorsqu'ils disent: „Auparavant les hommes se lamentaient différemment, ils poussaient des cris, tandis que maintenant ils s'adressent au défunt avec d'autres mots". Les pleureurs composent des vers pour des hommes jouissant d'une certaine renommée ou des jeunes gens mais s'abstiennent pour les femmes, ceci étant considéré comme une honte. Les compositeurs des vers sont aussi des hommes éminents.

Ces derniers temps en plus des pleureurs de confession catholique nous avons contactés des pleureurs de confession islamique. Ces derniers sont plus émotionnels. Les pleureurs accomplissent ce rite par obligation morale envers le défunt et la famille et aussi pour d'autres raisons. Ils respectent quelques règles fixes du cérémonial funèbre. Les improvisateurs sont des professionnels choisis. Au début de la lamentation ils informent l'opinion sur la cause qui a conduit le défunt à cet état et ensuite ils exposent les vertus qu'il avait de son vivant:

„Kjoft mallkue aj plum alltijet Qu'il soit maudit le plomb decce pistolet
që t'dau Can shpijet qui t'arracha Can aux gens
që t' dau ty prej t'tânë shoqinjet de ta maison qui te sépara de tous tes amis
e t'dau prej burrnijet qui te sépara de la compagnie
e të tjera" des hommes et ainsi de suite.

Les vertus du défunt sont présentées comme héréditaires, elles rejai-lleront sur les descendants. La plupart du temps le pleureur reflète l'état psychique de l'opinion. Il hyperbolise et accroît les mérites et les vertus du défunt qui sont nombreuses: le sens de l'honneur, l'hospitalité, la fidélité, la bravoure et autres. La plupart du temps il brosse le portrait physique du défunt après la mort.

Par le moyen d'une personnification, en insistant il prie le mort de se dresser de son cercueil, d'accueillir et d'accompagner les visiteurs en refusant d'accepter la réalité présente-:

„Çou, neshe vllazninë Lève-toi rencontre tes frères
çou neshe miqsinë Lève-toi rencontre tes amis
çou neshe kumarinë Lève-toi rencontre tes parrains"
e të tjera et ainsi de suite

Le souhait du pleureur est que défunt continue à accomplir de bonnes oeuvres dans l'autre vie, qu'il soit un chef comme il l' était dans ce monde quand il était vivant.

Il règne donc une croyance héritée des temps anciens selon laquelle le défunt ne meurt pas, mais se rend dans un autre monde: „Tu retrouveras ceux qui nous ont précédés, ceux qui ont emporté le Coutumier avec eux".

Le pleureur de confession islamique évoque souvent la nature, la vie champêtre d'autrefois pleine de dynamisme où l'on entendait le chant du

berger, ses jeux avec ses copains, l'écho des sonnailles, le bêlement des moutons lorsqu'il gardait le troupeau à travers les montagnes escarpées. Il décrit aussi d'autres circonstances de la vie humaine. Les pleureurs musulmans ne se présentent pas à l'opinion mais ils se lamentent après un intervalle de temps écoulé depuis la mort de la personne regrettée en travaillant, en voyageant ou dans d'autres occasions.

Le matériel glané sur les lieux montre que les récits des lamentations des hommes de Guci, Plave et des environs comptent environ 100 vers. Jour après jour leur texte s'étoffe, les lamentations s'enrichissent d'un sentiment profond spirituel qui les rapprochent de celles des femmes, cependant elles conservent leurs particularités spécifiques.